



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primijeng/Prodato Received/Delivery	15.12.2021	viti god year	2021
Organ /Njesia Organ./Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtjësja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTHCK	6143/2021		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.950/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.720/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.41/2020 të datës 19.02.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë: Rruga "28 nëntori" Komuna e Ferizajt, kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 14.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr. 41/2020, e datës 19.02.2020, e parashtruar nga ankuesi
- II. MBETET ne fuqi Vendimi Nr.123 i datës 21.01.2020 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

A r s y e t i m

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me datën 19.07.2019 nga Departamenti për Administrimit e Shërbimin Civil/ Ministria e Administratës Publike, ka pranuar autorizimin për shpalljen e konkursit për pozitën e punës "Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve" në Ferizaj, ndërsa ka shpallur konkursin me datë 24.07.2020.

Ankuesi ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe i njëjti është ftuar t'i nënshtrohet testit me shkrim dhe me gojë, mirëpo nuk ka arritur të zgjidhet si kandidat i suksesshëm.

Ankuesi i pakënaqur me Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 12.09.2019 të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me datë 07.10.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me datë 21.10.2019 i ka kthyer përgjigjen ankuesit se me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk është kompetentë për shqyrtimin e ankesave ndërsa të njëjtat mund të parashtrihen drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Ankuesi sipas udhëzimit, me datë 28.10.2019 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me A.nr.659/2019, ndërsa me datë 04.12.2019 Këshilli i ka përcjell ankuesit njoftimin se nuk mund të vendos lidhur me ankesën e datës 28.10.2019 pasi që ka mungesë të anëtarëve.

Ankuesi me datë 23.12.2019 ka parashtruar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies së Sociale propozimin për pezullim të procedurës së rekrutimit pasi që i njëjti ka parashtruar ankesë siç përcaktohet me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe po ashtu edhe në Këshill me datë 20.12.2019 ka parashtruar propozim për pezullim të procedurës së rekrutimit në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave me pas ka nxjerrë vendimin me numër prot:126 të datës 21.01.2020 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit të datës 07.10.2019 dhe e ka obliguar Zyrtarin kryesor administrativ të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që ta anulojë konkursin për pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve" në Ferizaj.

I pakënaqur me Vendimin numër-126 të datës 21.01.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, ankuesi me datë 19.02.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila është protokolluar me numër: 397/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 25.02.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse të Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa me datën 02.03.2020 dhe numër protokoll 548/2020 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Në mungesë të kuorumit për vendosje në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankuesi të njëjtën kohë ka hapur edhe konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, përmes Aktgjykimit A.nr.720/20 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoje dhe të vendos për ankesën e datës 19.02.2020 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e datës 19.02.2020 me numër protokoll 3976/2020 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Vendimin Nr.123 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale i datës 21.01.2020; Formulari i regjistrimit të ankesave me numër serik 00604; Ankesën e ankuesit të datës 28.10.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Njoftimin e datës 21.10.2019 dërguar përmes e-maili nga Njësia e Burimeve Njerëzore të MPMS për ankuesin; Formularin Form MAP-SHCK-06 për Njoftimin e kandidatëve për testimin nga përzgjedhja e ngushtë; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në MMPS; Propozimin lidhur me pezullimin e vendimit të datës 23.12.2019; Plotësim Ndryshimi i Propozimit lidhur me pezullimin e vendimit me datë 04.12.2019 me A.nr.659/2019 i parashtruar me datë 22.01.2020; Propozimin lidhur me pezullimin e vendimit me 04.12.2019 me A.nr.659/2019 i parashtruar në KPMSHCK me datë 20.12.2019; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.02.2020; Përgjigjen në kërkesë e datës 02.03.2020; Konkursin e datës 24.07.2019;

Autorizimin e DASHC/Ministria e Administratës Publike i datës 19.07.2021; Vendimin për themelimin e komisionit përzgjedhës i datës 09.08.2019; Akt emërimit të datës 01.09.2018; kërkesën për shpallje të konkursit të datës 11.07.2019; Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm të MPMS të datës 01.02.2019; Akt emërimit të datës 01.06.2018; Akt emërimit të datës 03.07.2017; Akt emërimit të datës 01.02.2019; Akt emërimit të datës 20.01.2015; Regjistrin e aplikacioneve të pranuar ndërmjet datave 24.07.2019 deri me datë 07.08.2019; Shkresën e njësisë së burimeve njerëzore me pikët e kandidatëve; testin me shkrim të kandidatës së përzgjedhur; Kopjen e dëshmisë së pranimit të aplikacionit të datës 09.08.2019; Kërkesa për punësim të kandidatës së përzgjedhur 07.08.2019; kopjen e letërnjoftimit të kandidatës së përzgjedhur; Diplomën e kandidatës së përzgjedhur të datës 29.08.2012 të lëshuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës; Kontratën e punës të datës 07.04.2017; Kontratën për themelimin e marrëdhënien e punës të datës 07.04.2014; Pasqyra e Llogarisë së Trustit për ankuesen; vendimin për nostrifikimin e diplomës së datës 26.12.2019; Kopjen e zarfit të datës 09.06.2019; Testin me shkrim i ankuesit; Kopjen e dëshmisë së pranimit të aplikacionit të datës 31.07.2019; Kërkesën për punësim të ankuesit të datës 31.07.2019; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; CV-n e ankuesit; Shkresën e pasqyrës së notave të ankuesit të lëshuar nga Kolegji AAB i datës 26.06.2019; Diplomën e ankuesit të datës 07.08.2010 me Nr.480/10; Çertifikatën e ankuesit lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj të datës 24.06.2019; Çertifikatën e trajnimit të datës 22.11.2014; Çertifikatën e trajnimit të datës 15.10.2015; Mirënjohjen e lëshuar nga FINCA e datës 17.12.2012; Çertifikatën e vitit 2008; Çertifikatën e punësimit të datës 02.10.2014; Shkresën e lëshuar nga Dusburg e datës 08.12.1999; Shkresën e lëshuar nga Dusburg e datës 18.05.2000; Shkresën e lëshuar nga Dusburg e datës 07.12.2000; Çertifikatën e datës 19.09.2006; Çertifikatën e datës 09.01.2007; Çertifikatën e datës 13.04.2006; Vendimin për zëvendësim në pozitë të përkohshme të datës të datës 27.03.2017; Formularët për Vlerësimin e kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për ankuesin; Formularët për Vlerësimin e kandidatëve për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj për kandidatin e përzgjedhur; Raporti final i rekomandimit nga komisioni rekrutues i datës 05.09.2019; Formulari Form:MAP-SHCK-10 për Renditjen përfundimtarë të kandidatëve; Formulari Form:MAP-SHCK-09 për përmbledhjen e vlerësimeve individuale; Njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 11.09.2019; Vendimin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të datës 21.01.2020; E-malin e datës 21.10.2021 dërguar nga Njësia e burimeve njerëzore e MPMS për ankuesi; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të datës 07.10.2019; Aktvendimin A.nr.720/20 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 27.09.2021; Padinë e paditësit së bashku me dosjen e bashkangjitur; Përgjigjen në padi të datës 14.10.2021 me numër protokolli 14.10.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është pa bazuar sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me Vendimin numër:126 të datës 21.01.2020 ka vepruar në kundërshtim me dispozita ligjore pasi që nuk është dashur të anulohet procedura e rekrutimit në tersi mirëpo vetëm të shfuqizohet njoftimi për kandidatin e suksesshëm dhe të pranohet ankuesi në pozitën e "Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve".

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, gjatë analizimit të provave të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave ka nxjerrë Vendimin me numër prot:126 të datës 21.01.2020 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesit të datës 07.10.2019 dhe e ka obliguar zyrtarin kryesor administrativ të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies

Sociale që ta anulojë konkursin për pozitën "Udhëheqës i Zyrës së pensioneve në Ferizaj", me arsyetimin se testi me shkrim i datës 27.08.2019 nuk ka qenë në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil neni 36 paragrafi 1 nënparagrafët 1.1; 1.2 dhe 1.3, e ne rastin konkret Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave nuk ka qenë objektiv në arsyetim dhe shkakun e anulimit të konkursit për pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve", pasi që janë evidentuar shkelje tjera në procedurë.

Kolegji, po ashtu ka konstatuar se konkursi i datës 24.07.2019 ka qenë i shpallur për pesëmbëdhjetë (15) ditë, e si ditë e mbylljes së konkursit është llogaritur data 07.08.2019, ndërsa në bazë Formularit Form-MAP-SHCK-04 i Regjistrimit të aplikacioneve të pranuar është evidentuar se kandidatja e përzgjedhur ka aplikuar në konkurs përmes postës me datë 07.08.2019, mirëpo në dosjen e kandidates së përzgjedhur Kolegji ka evidentuar një dokument-vendim të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me numër reference-6/4-106 të datës 26.12.2019 i cili dëshmon nostrifikimin e diplomës së fituar jashtë vendi, në Republikën e Maqedonisë, për kandidaten e përzgjedhur është bere pjese e dosjes pas përfundimit te procedurës se rekrutimit, e që rrjedhimisht ky fakt është dashur të shërbej si arsye për anulimin e procedurës së rekrutimit pasi që sipas dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ nr.12/2018 për parimet dhe procedurat e njohjes se diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës neni 3 paragrafi përcakton se *"Të gjitha diplomat e shkollave të larta profesionale si dhe ato universitare të fituara jashtë vendi me qëllim punësimi, do t'u nënshtrohen procedurave të njohjes/barasvlerës në MASHT, 2.Njohja/Barasvlera e diplomave me qëllim të punësimit në Republikën e Kosovës është kompetencë e Qendrës NARIC në MASHT"*, si dhe në bazë të provave të lëndës është konstatuar po ashtu se njoftimi për kandidaten e suksesshme është i datës 12.09.2019 e që rrjedhimisht Komisioni Përzgjedhë i Shërbimit Civil ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kritereve si në vijim: arsimimi dhe kualifikimi profesional"*, pasi që aplikacioni i kandidates së përzgjedhur nuk i ka qenë i kompletuar me rastin e dorëzimit ngase nostrifikimi i diplomës së fituar jashtë vendi duhet t'i bashkëngjitet dokumenteve në momentin e aplikimit, e jo pasi që janë përfunduar të gjitha fazat e rekrutimit, andaj me këtë rast procedura e rekrutimit për pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve" është zhvilluar në kundërshtim me 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton që: *"Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës"* dhe si e tillë procedura e rekrutimit duhet të anulohet si dhe të gjitha efektet që rrjedhin prej saj, ndërsa ankesa e ankuesit është e pa bazuar, andaj për këtë shkak Kolegji nuk është lëshuar në pretendimet tjera ankimore të ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.123 të datës 21.01.2021 lidhur me anulimin e konkursit për pozitën "Udhëheqës i Zyrës së Pensioneve-Ferizaj", ka vepruar në pajtim me dispozitat e të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Andaj pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar ne nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.950/2021

Elakron GASHI



Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Udhëheqësit të Personelit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve;
- Arkivit të KPMSHCK-së

